



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 6-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.03.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturiye Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragacina, anëtare

28. Besiana Syla, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Anila Reçica, DKRS
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Bekim Shabani, DP
8. Shkelzen Hajdini, DSH
9. Imer Rustemi, DSHPMSH
10. Flamur Sylejamni, DI
11. Elmaze Behluli, DA
12. Sead Aliu, DI
13. Rexhep Rexhepi, DBP
14. Rasim Hasani, DA
15. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e IV (jashtëzakonshme) dhe e V-të e Kuvendit.

2. Raporti vjetor janar-dhjetor 2021 i punës së Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale.

3. Propozim për miratimin e nëntë (9) Vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës në nëntë (9) lokacione të ndryshme, si monumente natyrore.

4. Propozim vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë jofitimprurëse të përfituesve të banesave sociale.

5. Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

6. Propozim-Vendim për krijimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të shfrytëzimit afatgjatë të pasurive të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

7. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pronës për instalimin e transformatorit në Lipjan.

8. Propozim-Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë (2022-2024) Lipjan.

9. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerët.

10. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

11. Propozim-vendim për vazhdimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave vendorë.

12. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit zgjedhor të këshillave vendorë.

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtareve të kuvendit.

Egzona Bytyqi, tha se i kam për ti ngritur disa çështje karshi momentumit në të cilën po ndodhemi, në interes të komunitetit në përgjithësi. Unë kam një propozim që të krijohen kushtet sikurse në fillim të pandemisë për ndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet të cilat janë në nevojë. Çështja e dytë ka të bëjë me rritjen e çmimeve bazike ushqimore dhe të karburanteve, kërkesë e qytetarëve është se apo mbikëqyren këto kompani dhe a është arrit të bëhet një inspektim gjithë përfshirës. Çështja tjetër ka të bëjë me ndezjen e zjarreve nga faktori njeri siç ka ndodhur rasti i fundit në fshatin Kraishtë, ku kërkoj nga drejtorati përkatës të merret me këto çështje të filloj me broshura për rreziqet që i ka dëmtimi i pyjeve.

Ganimete Qeriqi, tha kam një kërkesë që të bëhet një dokumentar për të mbijetuarën e luftës së fundit Shemsije Vishesella, e cila e ka të vrrarë të dy djemtë dhe burrin e saj dhe vet ka mbet invalidë. Na ndihmota realizojme këtë pasi që kjo familje asnjë ndihmë kapitale se ka pas. Dhe të fillojmë nga ky rast e do të ngrisim edhe rastet tjera një nga një. Po ashtu të bëhet edhe një dokumentar për Kongresin e Lipovicës.

Majlinda Sylejmani, tha se kam për ta ngritur një çështje rreth renovimit të objekteve banesore në qytetin e Lipjanit, në projekt shumë i rëndësishëm për banorët e këtyre objekteve. Pyetja ime është kush ka qenë personi përgjegjës nga komuna për me i mbikëqyrë këto punime. Pasi që objekti të sheshi Adem Jashari ka pas një temp të ngadalshme të punës. Dhe disa pjesë të jashtme kanë punime jo të mira. Pyetja tjetër, kur parashihet me filluar riasfaltimi i rrugës Zylfie Gashi dhe Isa Olluri.

Besiana Syla, tha se kam ta ngris një çështje që është me rëndësi dhe urgjente për qytetarët e ka të bëjë me qenët endacak ku po ka raste kur qytetarët edhe po sulmohen. Ky shqetësim është si në qytet ashtu edhe në fshatra, e ku për këtë temë është diskutuar edhe në seancat e kaluara mirëpo nuk janë ndërmarr masa konkrete. Tash kur te pritët të bëhet projektimi i buxhetit në muajt në vazhdim komuna do të duhej të ndante mjete dhe ndonjë parcelë në ndonjë vend të përshtatshëm ku do të ndërtoheshin strehimore për strehimin e qenve endacak. Ku qytetarët nuk do të ndiheshin të rrezikuar.

Rinor Mrati, thase kam për ta ngritur një çështje, në vitin e kaluar pata bërë një peticion online për vendosjen e mbrojtëseve në rrugët e qytetit ku rrezikshmëri që shkaktohet nga kalueshmëria e rrugës nga qytetarët duke mos i shfrytëzuar vendet e posaçme. Duke e konsideruar afër shkollave si zonën me rrezikshmërinë më të lartë propozoj që të vendosen mbrojtëset në të dy trotualet apo në mes të rrugës afër shkollave, në "Ismajl Luma", "Vëllëzërit Frashëri" dhe te shkollat e Mesme e me këtë do të ulëj rrezikshmëria gjatë vozitjes për qytetarët. Po ashtu te rruga "Hajredin Bjarami" ka një kërkesë të qytetarëve për vendosjen e zebrave në rrugë. Po ashtu kërkoj nga drejtori për SHPMSH, që ta shtoj mirëmbajtjen e ndriçimit publik . Pyetje për DKA-në, kur pritët të bëhet transferimi i mjeteve të bursave komunale për studentët përfitues.

Ardit Cani, tha se kam një kërkesë për ndërtimin e trotuarit prej burimit të ujit i nxehtë deri te fshati Bincë një projekt ku do të krijonte mundësi të shumta për hapjen e bizneseve nga banorët e asaj pjese. Ku ka qenë në takim edhe drejtori i infrastrukturës lokale në takim Sead Aliu, i cili e ka pa për së afërmi gjendjen aty ,ku ne atë pjesë ka hapësirë të mjaftueshme. Dhe kërkesa e dytë ka të bëjë nga disa mësimdhënës kur pritët të filloj pagesa e shujtave për mësimdhënës.

Xhyzide Rrusetmi, tha se unë i kam disa kërkesa të banorëve të fshatit Banullë, se pari vendosja e zebrave te shkolla e fshatit. Pasi që ne atë pjesë vozitet me shpejtësi të madhe, dhe ka qarkullim të madh të nxënësve. Kërkesa e dytë ka të bëjë

me vazhdimin e trotuarit ne rrugën Livadhet e Thata pasi qe gjatë vërshimeve është dëmtuar.

Bashkim Budakova, tha kam dy pyetje e para ka të bëjë nga mësimdhënësit se deri ku ka shkuar pagesa e shujtës dhe udhëtimit. Pasi qe një pjesë e komunave e kanë kryer këtë obligim. E dyta ka të bëjë me deponitë ilegale, ku kemi një rast në rrugën Rubofc Lipjan dhe nuk e di a është në dijeni inspektorati për këtë.

Lulzim Rustemi, tha kam një propozim qe ndriçimi në rrugët regjionale në Lipjan të ç'kyçen nga ora 23 ose 24 pasi qe është një shpenzim i pa nevojshëm. E dyta ka një kërkesë nga banorët e fshatit Konjuh për ndriçim publik, prej hyrjes së fshatit deri te autostrada një pjese afër 250 metra, Po ashtu kërkesë e këtyre banorëve është edhe bartja e nxënësve në shkollë. Pyetja tjetër te udhëkryqi Lipjan -Shtime, aty ka makineri ka zhavorr, a ka ndonjë rregullore për shfrytëzimin e saj. Është mirë ajo pronë me u dhanë në shfrytëzim për çka është paraparë. Pyetja tjetër ka të bëjë me DKA-në, rreth bursave ku disa nga studentet me ankesa kanë fituar bursën për shkak te gabimeve teknike.

Fadil Spahiu, tha se i kam dy kërkesa të qytetarëve, e para ka të bëjë me fshatin Llugaxhi, në rrugën "Fatmir Reqica" gjatë punimeve është mbyll kanal i ujërave, ku gjatë vërshimeve aty ka probleme dhe kërkesa e tyre është te hapet ai kanal. Pyetja e dytë ka të bëjë me banorët e fshatit Honrovc te cilët kanë dal në Lipjan dhe lagjja e tyre të emërohet si lagjja e Honrovcit apo lagjja e Gajtanëve. Po ashtu edhe ndërtimi i një ure dhe zhavorrimi i rrugës në Honrovc.

Lumturije Bytyqi-Hasani, se kam një kërkesë qe te filloj subvencionimi i grave te cilat lindin fëmijë në komunën tonë dhe fillimisht te fillohet me gratë të cilat janë të pa puna. Dhe do te ishte mirë qe në të ardhmen komuna e Lipjanit te iniciante ndryshimin e rregullores për subvencionet dhe te futet edhe gratë qe lindin foshnje. Pasi shumica e komunave e kane këtë te rregulluar. Çështje e dyte ka të bëjë me rritjen e çmimit të produkteve, por deri me tani nuk kemi par ndonjë inspektim nga komuna jonë. Rruga Tahir Sinani, është bërë një prishje dhe është mirë me intervenua deri te bëhet asfaltimi i asaj rruge, pasi qe po shkaktohen aksidente ne atë rrugë.

Arsim Jashari, tha se çështja e parë ka të bëjë me rregulloren e varrezave, ku i ka vetëm dy mangësi e para mos me i lanë varrezat me u ndërtuar afër shtëpive, ku fshati im i ka disa varreza. Është mirë me u ndryshuar kjo rregullore. E dyta, gjendja në shkollën fillore "Emin Duraku" në Bnauullë, dhe e AMF-së në Banullë janë në

gjendje të tmerrshme. Ku se fundmi AMF-ja është dëmtuar janë vjedhur pajisjet dhe dikush duhet me dhënë llogari.

Alban Salihu, tha se kam disa kërkesa te qytetarëve, të cilat mi kanë dërguar, ku shënon se në rrugën Hamdi Bislimi rrugica Haxhi Zeka nuk është asfaltuar pse ka ndodhur kjo, edhe pse banorëve ju është thënë të bëhet kërkesë në komunë dhe është bërë kërkesa prapë ajo rrugicë nuk është asfaltuar. Cila është arsyeja pse kjo rrugicë nuk është asfaltuar. Çështja e dytë ka të bëjë me profesionistët shëndetësor për pagesën e kujdestarisë për ditët e vikendeve dhe kujdestarinë e natës, që ju takon sipas ligjit. Dhe e fundit demolomi i objekteve publike ku ne fshatin tim janë 4 objekte e te cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në histori.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha,sa i përket rritjes se çmimeve deri tani nuk kemi një mundësi të tillë për pako ushqimore, por presim nga qeveria që të ketë rishikime buxhetore dhe të përfshihet pasi që për momentin nuk kemi bazë ligjore dhe nuk mund të hyjmë. Te kontrolla e çmimeve ,tani Lipjani nuk kanë inspektor sanitar pasi që janë shkuar në nivel qendror. Ka pas kontrolla të përgjithshme kontrole ne furra te bukës. Inspektoret tani janë përpjek me qenë shumë aktiv. Zjarri është evident ne komunën tonë, por numri i zjarrfikësve është i vogël,por po presim me rritë numrin dhe na duhet një rigjenerim. Unë jam pro dokumentarëve te cilët u ngritën nga asamblesitja. Renovimi eficient, kemi pas telashe për shkak te terasave pa leje dhe për shkak te kablllove te rrjetit dhe qytetarët nuk kanë ndihmuar. Rruga “Zylfie Gashi”, pritët shume shpejtë me filluar punimet. Ndërsa në rrugën Isa Olluri aty do të bëhet restaurimi i trotuarit dhe ndriçimi publik. Qentë endacak është problem vendi që nuk po gjene zgjidhjen e përhershme por vetëm atë hok. Komunitat e Kosovës kanë pas takim për te diskutuara për këtë temë. Vendosja e mbrojtësve në rrugën 4 kursi dhe afër shkollave, nuk e kam pas si ide kurrë por për mendimin tim do te bënim kufizime. Këtu na vyen një vlerësim profesional me inxhinierët dhe stacionin policor dhe do ta diskutoj me përgjegjësit. Bursat kanë filluar të kryhen sot. Sa i përket investimeve të burimet e ujit, drejtori Seadi me ka njoftua që ka qenë në vizitë në atë pjesë dhe do të shohim mundësinë, dhe nëse nuk kemi probleme pronësore do te shohim tutje. Shujta në arsim ka rrjedh prej kontratës kolektive dhe kjo nga asnjë qeveri nuk na është lejuar me paguar, dhe kjo është çështje e nivelit qendror. Vendosja e zebrave para shkollave ne rrugë, dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale do të bëhet. Trotuari në Banullë është problem pronësor. Sa i përket deponive na i kemi hiç me herët por na duhet prapë me veprua te njëjtë, na ju kemi dërguar secilës familje nga një shportë të mbeturinave dhe ata me asistencë sociale i kemi liruar. Janë shpërnda afër 10 mijë shporta te mbeturinave. Në Konjuh,

ne pjesën ku i cek ka problem pronësor dhe nuk na kanë lejuar me punuar aty. Te prona te Sitnica problem i trashëguar, statusi i kësaj pronë është me telashe. Tani ne duhet me bërë debat te gjithë se bashku për atë pronë. Te bursat kanë qenë disa gabime teknike të cilat duhen plotësuar, rregullorja është zbatuar ne përpikëri. Ajo rregullore duhet ndryshuar dhe është në konsultim publik dhe duhet edhe ndihma juaj. Në Llugaxhi janë duke u vazhduar punimet, por nuk e di çka ka ndodhë aty por ekipet dalin ne teren dhe e shikojnë punën aty. Ne shumë shpejtë do ta sjellim në kuvend komisionit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në fshatra. Në Honrovc do ta shtime ne agjente te paken për zhavorrim. Për lindjen e foshnjave për subvencionim na kemi vullnet por duhet te jetë një rregullore e njëjtë për të gjitha komunat ku te paguajnë njëjtë të gjitha jo një komunë një shumë, tjetra një shumë tjetër. Rregullorja për varreza, do te hyjmë në rishikim për ndryshim plotësim. Shkolla fillore në Banullë dhe AMF, duhet bashkërisht me vendose se çka duhet te bëjmë me atë objekt, ideja është ose te behet një çerdhe e përbashkët për ato fshatra, ose te ftohen donatorët. Te shtëpia e shëndetit ka ndodhë një huliganizëm, dhe organet e hetuesisë janë duke u marr me rastin. Ne nuk i kemi tërheq mjetet për shkak se situatës me të cilën gjendemi.

Ganimete Qeriqi, tha se e falënderoj kryetarin për mbështetjen dhe përgjigjen për rastin në fjalë.

Arsim Jashari, tha aty ne atë shtëpi të shëndetit janë vjedhur të gjitha pajisjet dhe aty nuk ka mbetur asgjë. Po ashtu tha se ne si fshat e kemi marr një iniciativë për pastrimin e fshatit Banullë dhe do të ishte mirë qe edhe ju te merrni iniciativa për vendbanimin tuaj. Pasi me këtë do te vetëdijesoheshin se pari fëmijët tanë dhe të gjithë ata qe na shohin.

Daut Azemi, kryesues i kuvendnit tha se e falënderojë kryetarin për gatishmërinë për të marr pjesë në secilën seancë të kuvendit dhe për të ju përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të kuvendit.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e IV (jashtëzakonshme) dhe e V-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shahadije Dragaçina, tha se është një gabim teknik te pjesa ku shënohet aty për shkak perspektives .

Pastaj Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e IV (jashtëzakonshme) dhe e V-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me përmirësimin e gabimit teknik, me 30 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja IV (jashtëzakonshme) dhe e V-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Raporti vjetor janar-dhjetor 2021 i punës së Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmetit, kryetarit të komunës , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se ky raport paraqet punën menaxheriale të ekzekutivit dhe përmban një rezultat të mirë që përputhet me gjendjen buxhetore. Shihet që është një raport me rezultate mbi mesataren , që kalon të hyrat mbi 96% .Në këtë raport shihet se janë realizuar një numër i madh i projekteve kryesisht infrastrukturore, hapësirat publike e të tjera. Edhe pse ka qenë vit me pandeminë dhe është përball me disa sfida. Komuna jonë po vazhdon të vlerësohet lartë për performancën dhe transparencën si nga institucionet vendore edhe ato ndërkombëtare Ne emër të grupit të LDK-së ju falënderojmë për këtë raport dhe ju rekomandojmë të vazhdoni me punë të njëjta të mira. Për fund tha u'a uroj muajin e shenjtë të ramazanit të gjithë besimtarëve mysliman

Shahadije Dragaçina, tha se raporti i kryetarit dhe drejtorateve, është me shumë statistikor dhe aspak analitik. Ne duhet të dijmë edhe sfidat reale .Neve dhe publikun na duhet me ditë se cilat punë janë kryer. Përshembull te drejtoria i shëndetësisë thuhet se janë bërë disa investime, mirëpo çka kanë përfituar qytetarët a ka pas rezultate në këtë drejtim. Po ashtu ne arsim përmendet numri i madh i paraleleve nëpër shkollë, ndërsa kemi paralele me numër të madh të nxënësve. Çka ka ndërmarr komuna për ti riorganizuar këta nxënës. Pse nuk i cekni problemet ne

këtë raport. Po ashtu te njësia e auditimit të mbrëmshëm kemi vetëm statistika se auditive janë bërë sa trajnime kanë shkuar, ndërsa nuk po informohemi se çka konkretisht kanë gjetur auditorët.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, hyni në faqe të komunës dhe aty e gjen qe raporti i auditorit ,çdo vit publikohet dhe te gjitha gjetjet i keni aty. Këtu ka statistika dhe ne nuk bëjmë analiza se nuk jemi institut ne për analiza. Asnjë shifër as nuk është fsheh as nuk ka me guxua me u fsheh dhe 7 herë e ka marr komuna e Lipjanit vendin e par ndër komunat e pakta.

Shahadije Dragaçina, unë e ceka qe në raportin e auditorit ka pas vetëm statistika. E dyta çka ka bo drejtorja e arsimit për paralelet qe kanë numër të madh të nxënësve nëpër shkolla, ndërsa shkollat afër tyre kanë numër të vogël të nxënësve. Çfarë cilësie e arsimit po ju epet atyre nxënësve.

Imri Ahmeti, kryetari i Komunës tha, se mas pari a e dini se çka punon auditorin i mbrëmshëm i komunës me cilin ligj punon. Auditori i mbrëmshëm është organ qe i ep llogari vetëm kryetarit të komunës.

Besiana Sylja, tha se sa i përket raportit të kryetarit,ne vitin 2021 janë realizuar 110 projekte kryesisht në kanalizim, ujësjellës, ndriçim publik, ku pjesëmarrja në shpenzimin e buxhetit është e kënaqshme. Kërkoj qe ato projekte te kenë qëndrueshmëri, pasi qe te disa investime ne rrugë e rrugica po shihen te metat e investimit. Çka do të ndërmerr komuna qe këto të meta të përmirësohen. Po ashtu sipas avokates publike,keni shumë lëndë në gjykata qoftë civile dhe përmbartimore dhe aty ka shumë shpenzime. Çka do të ndërmarr komuna qe te siguroj mjete ne mënyre qe mos te dëmtohet buxheti i planifikuar .Te testi ndërkombëtar Pisa kemi rezultat negativ të testimit të nxënësve, po ashtu edhe ne nivel komune. Çka do të ndërmarr komuna qe te përmirësohen rezultatet ne arsim

Lulzim Rrustemi, tha një raport mjaft voluminoz, kemi rritje të të hyrave vetanake, por ka edhe te meta dhe nevojë për përmirësime. Është kanë mirë me u plotësuar me te dhëna me te shumta. Sa i përket sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore, nuk po duket qe po kryejnë punën si duhet pasi qe shume vendime të cilat po dërgohen ne ministri po na kthehen negativ. Zyra ligjore duhet te gjitha rregulloret, vendimet me i filtrua. Te DKA, ka nevojë me investuar dhe me punuar shumë,ku testi i maturës dhe arritshmërisë është jo i kënaqshëm. Po ashtu mungojnë tabelat se sa nxënës e kanë lënë mësimin, sa mësimdhënës punën . Po ashtu edhe gjendja higjienike nuk është ne nivelin e duhur. Te DKRS-ja kemi një raport rutine

nuk ka kreativitet, stadiumet se di a janë vizituar nga drejtoresha ndonjë herë ne Mgaurë dhe Dobrajë aty janë ne gjendje te mjerueshme. Te drejtoria për buxhet dhe Financa: Pagesat e përfituesve individual cilat kategori janë subvencionuar me këtë shumë. Te parku industrial në Qylagë ende kemi punë për te bërë . Zona e QMI-së nuk po përmenden fare. Te shëndetësia ka nevojë për përmirësime. Te Urbanizmi më shumë janë marr me hartat zonale, por sa i përket te tjerave ka pas ngecje dhe mungesa te mëdha. Te Shërbimet Publike, projekte te shumta por cilësia jo ne nivel te duhur, dhe punët po kryhen pa asnjë kriter, po anashkalohen disa rrugë shumë të rëndësishme.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, te parku industrial po vazhdojnë punimet por aty kemi marrëveshje me Mistrinë e Tregtisë dhe Industrisë,por sa here po ndërrohen qeveritë po na vonohen punët. Nuk pres qe zona ekonomike ne Qylagë shpejt me u bo funksionale. Përfituesit individual ,90% te tyre janë shpenzime te varrimit dhe te gjitha këto janë të publikuara. Nuk ka pas selektim te investimeve ka mujtë ndonjë me u harru, por te gjitha do te përpunojnë. Te stadiumet janë kontrata 2 vjeçare, por ka qenë edhe koha e kovidit. Stadiumi në Dobrajë ka përfunduar, te gjitha pajisjet ju ka shkuar, tash ne varet te klubet si e menaxhojnë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha kam vërejtje te sektori për mardhënje me publikut nuk i jep hapësirë të mjaftueshme kuvendit, po ashtu po mungojnë videot e mbledhjeve te kuvendnit live. Po ashtu te zyra e protokollit nuk kem informata sa takime zyrtare i ka pas kryetari jashtë vendit sa takime brenda vendit. Aneksi i shkollës në Lipjan nuk është qe është bërë zgjidhje, po ashtu nuk është bërë kompletimi i klasave. Numri i nxënësve qe kanë braktisur mësimin nuk është cekur. Te shtigjet e ecjes një projekt mjaft i qëlluar, por ka filluar te demolohet ajo pjesë. Te pagat jubilarë te shëndetësisë pse ende disa punëtor si kanë marr ato paga.

Bashkim Budakova, tha sa i përket raportit, do të fokusohem te sektori i arsimit, te testi i maturës ku në shkollën Adem Gllavica nuk e kanë kaluar testin mbi 83% e nxënësve. Po ashtu sfidë ka qenë edhe zëvendësimi i personelit arsimor te cilët kanë qenë të infektuar me Covid-19 e ku shumë, orë kanë mbet pa u zëvendësuar fare. Raporti ka shumë gabime gjuhësore.

Imri Ahmeti,kryetari i komunës tha se sa i përket shtigjeve të ecjes nuk janë pranuar ato ende dhe nuk janë paguar shpenzimet e operatorit, dhe pritet te shkoj lënda në gjykatë. Ne kemi bërë edhe ekspertizë private për këtë çështje. Sa i përket

aneksit të shkollës është ma mirë se si ka qenë më herët. Sa i përket sektorit të informimit na çdoherë e kemi zënë vendin e parë për performancë.

Pastaj Kryesuesi dha pauze nga ora 12:00 deri në 13:30

Pas pauzës u vazhdua në pjesën e dytë të mbledhjes duke vazhduar në pikën në vazhdim.

III

Propozim për miratimin e nëntë (9) Vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës në nëntë (9) lokacione të ndryshme, si monumete natyrore.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishtit, drejtor i DPUMJ-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Arsim Jashari, tha se si grup i PDK-së e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim, një propozim shumë i mirë të cilin e mbështesim mbështesim.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi vendimin për miratimin e nëntë (9) Vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës në nëntë (9) lokacione të ndryshme, si monumete natyrore.

IV

Propozim vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë jofitimprurëse të përfituesve të banesave sociale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacolli drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ne edhe në KPF e kemi diskutuar këtë propozim vendim. Në parim e përkrahim dhe ndihemi mirë që po kemi mundësi me ju dal në ndihmë kësaj kategorie. A ka banesa tjera te cilat ende nuk janë dhënë në shfrytëzim.

Shahadije Dragaçina, na e përkrahim këtë propozim vendim por është dashtë që me iu bashkëngjitë lista e familjeve. Dhe a ka ndonjë familje prej tyre që i kanë kryer obligimet apo nuk ka asnjë. A ka pas ndonjë komision që e ka verifikuar mos ka ndryshuar gjendja ekonomike e këtyre familjeve.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne e përkrahim këtë propozim vendim por është mirë me u liruar edhe disa kategori siç i patëm liruar ne pandemi, siç janë bizneset që shfrytëzojnë hapësirat publike që është gastronomia .

Valon Pacolli, tha se lista e përfituesve është publike në faqen e komunës. Ndërsa sa i përket banesave i kemi 10 banesa të lira për momentin.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha, meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë jofitimprurëse të përfituesve të banesave sociale.

V

Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, tha se një propozim shumë i vlefshëm për qytetarët e Lipjanit që ka një rëndësi të veçantë. Këto parcela a janë të lira apo që kanë qenë në shfrytëzim më herët. Unë kisha propozua që këto parcela të ndahen në parcela të vogla e jo të ju epen me ka 1 e 2 hektarë.

Fadil Spahiu, tha se kam një pyetje mbi bazën të kujt është marrë ky propozim vendim, a është marr në bazë të kërkesës së ndonjë personi, a po është vlerësuar vet si zonë që mundet me ardhë investimi.

Valon Pacolli, tha se propozimet e Lulit do të merren parasysht. Parcelat kanë qenë të lira më herët. Kërkesa është e ekzekutivit që me shfrytëzuar atë pronë të mirë që e ka komuna.

Lulzim Rustemi, tha se herët tjera është mirë me ardh me projektor me i shikuar anëtarët e kuvendit se për cilën zonë po bëhet fjalë.

Daut Azemi, tha se në materialet i keni marr të gjitha me kohë, por do ta kemi parasysh edhe propozimin tuaj për mbledhjet e ardhshme.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

VI

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të shfrytëzimit afatgjatë të pasurive të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së e propozojmë Armetn Grajqevcin.

Arsim Jashari, tha se ne në emër të grupit të PDK-së e propozojmë Lulzim Rustemin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të shfrytëzimit afatgjatë të pasurive të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

VII

Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pronës për instalimin e transformatorit në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishti, drejtor i DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, 5 abstenime, vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pronës për instalimin e transformatorit në Lipjan.

VIII

Propozim-Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë (2022-2024) Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Anila Reqica-Llugiqi, drejtoreshë e DKRS e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se Komiteti për Kulture Rini dhe Sport kanë mbajtur një takim dhe po ua kaloj fjalën dikujt nga komiteti nëse kanë ndonjë rekomandim.

Rinor Murati, tha se ne në Komiteti për Kulture Rini dhe Sport, kemi diskutuar edhe për këtë pikë, ne mendojmë që ky propozim vendim kontribuon në të mirën e rinisë sonë dhe e mbështesim si plan por duke i bashkëngjitur edhe propozimin tonë për zgjedhjen e vullnetarit, apo vullnetarëve të vitit nga sektori i rinisë e të cilët do të zgjedhë Drejtorati për Kulture dhe do të marrin një shpërblim si stimulim për punën e tij vullnetare.

Arsim Jashari, tha se ne këtë propozim e kemi diskutuar edhe në KPF, dhe na kemi një propozim që të futet një program për risocializimin dhe eliminimin e dukurive negative nga mosha 14 deri 16 vjeç. Ku i kemi 4 faktorë i pari faktori familje, i dyti lagjja, i treti një shkollë e mundshme dhe bartja nga fshati në qytet dhe anasjelltas. Është mirë me bërë një plan me shkuar nëpër shkolla me këtë plan. Unë pajtona që të zgjidhet vullnetari i vitit por ne faqe të komunës nuk kemi pas asnjë propozim nga rini për këtë plan dhe kjo është shqetësuese. Ne e mbështesim këtë propozim nëse hyn edhe propozimi jonë.

Lumturiye Bytyqi-Hasani, rininë ky ekzekutiv e ka lanë anash, dhe njëra nga pikat e këtij propozimi është aftësimi i rinisë për tregun e punës. Ju në fushatë e pat premtuar një praktike për studentë në komunë, po ashtu për praktikë të nxënësve të drejtimeve teknike në kompanitë private.

Rinor Murati, tha se është mbajtur një dëgjim publik që kanë ardhur disa propozime nga rinia. Por propozimi jonë si komitet ke që të jetë edhe vullnetari apo vullnetarët e vitit.

Arsim Jashari, tha se ne nuk jemi kundër vullnetarit të vitit po ma e rëndësishme do të ishte propozimi jonë risocializimi nëpër shkolla. Se ne do ta përkrahim edhe vullnetarin e vitit.

Daut Azemi, tha se ne njërin nga takimet me rininë kam qenë edhe unë.

Anila Reqica-LLugiqi, tha obligimi jon ka qenë me qit ne faqe të komunës, dhe aty kane qenë edhe propozimet. Vullnetarin e vitit e kemi parapa edhe ne plan qe është pika te vullnetarizmi. Dhe po mundohemi ta bëjmë më të mirën për rininë.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Me qe diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për,6 kundër aprovoi Vendimin për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë (2022-2024) Lipjan.

IX

Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerët.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rexhep Rexhepi, drejtor i DB, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ne si grup jemi pro këtij propozimi,por kërkojmë qe procesi të jetë transparent dhe shpërndarja të mos jetë e një anshme. Po ashtu kërkojmë te formohet një komision për mbikëqyrje te përfituesve.

Rexhep Rexhepi, tha se komisioni ka qenë edhe në të kaluarën dhe e kanë obligim ne afatin 3 vjeçar me përcjellë përfituesin.

Alban Salihu, tha është e rëndësishme me u nda në mënyre të drejtë ato sera, dhe është mirë te vëzhgohen nga komisioni se për çka po i shfrytëzojnë ato sera përfituesit.

Rexhep Rexhepi, tha se edhe në të kaluarën ka pas keqpërdorime dhe janë konfiskuar disa motokultivator se bashku me policinë.

Alban Salihu, tha duhet te vëzhgohen përfituesit e serave, pasi edhe pse po i marrin nuk po i mbjellin por po i marrin për diçka tjetër.

Lulzim Rrstemi, tha se ekzekutivi duhet em qyre apo ka zhvillim kush po përfiton, apo punësohet dikush ne aty sera dhe mandatin tjetër ati qe ja kemi dhënë 5 ari dhe ka zhvillim me ja dhënë 10 ari. Ata qe kanë ngecje mos me ju dhanë. Dhe është obligim i komisionit me dhanë raport para kuvendit rreth përfituesve rreth punës qe po e bëjnë.

Armend Grajgevc, tha se ne si grup i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Megë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerët.

X

Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behlulit drejtoreshë e DA, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se duke e pa gjendjen ekonomike në të cilën po gjendemi, kjo shumë nuk është e vogël por unë e kam një respekt te veçantë për punëtorët e administratës, dhe për hatër të kontributit të tyre, qe ka dhënë e sidomos në kohën e pandemisë, ne do të votojmë për dhe pse ne si grup nuk do të marrim pjesë në këtë eskurzion .

Lumturiqe Bytyqi-Hasani, tha se jemi për ti përkrahur këto shëtitje, e sidomos pas një kohe të kaluar me pandeminë, mirëpo vitet e kaluara kur kemi nda mjete për sindikatën e administratës nuk kemi nda paralel edhe për sindikatat tjera si ajo e arsimit e shëndetësisë. Dhe kjo mendoj qe është e pa drejtë, pasi qe duhet te jenë të gjithë të njëjtë.

Alban Salihu, tha se ne si grup do të votojmë kundër këtij propozimi.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se sindikata i ka mjetet e veta qe paguajnë çdo muaj nga 2 apo 3 euro dhe kjo është vetëm një mbështetje. Dhe në rast qe nuk shpenzohet këto mjete kthehen prapë. Edhe anëtarët e kuvendit janë të ftuar në këtë eskursion.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, 6 kundër aprovoi vendimin për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

XI

Propozim-vendim për vazhdimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave vendorë.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behluli drejtoreshë e DA, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ide shumë e qëlluar dhe këshillat e fshatrave ndihmojnë shumë dhe na e mbështesim këtë propozim.

Daut Azemi, tha se këto këshilla kanë qenë edhe më herët por për shkak të pandemisë janë ndërpre.

Fadil Spahiu, tha se çka do të ndodhë me mandatin e atyre që janë zgjedhë para dy viteve a do të ju vazhdohet atyre, apo do të vazhdoj nga fillimi.

Daut Azemi, tha se procesi do të vazhdoj aty ku ka mbetë, momentin që do të përfundoj krejt procesi komisioni do të vij me raport në kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi vendimin për vazhdimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave vendorë.

XII

Propozim-vendim për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit zgjedhor të këshillave vendorë.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Elmaze Behluli, drejtoreshë e DA, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Fitim Shala, tha se në emër të grupit të LDK-së, e propozojmë Majlinda Sylejmanin për kryesuese dhe Rinor Muratin për anëtar.

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së për anëtar të këtij komisioni e propozojmë Fadil Spahiun.

Shahadije Dragaçina, tha se ne si grup i LVV-së e propozojmë Fadil Spahiun

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi vendimin për vazhdimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave vendorë.:

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,00

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi